



Data: 11/09/2020 Ref.: 1567/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

#### V E N D I M

- I. Miratohet kërkesa e Universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka" nr. 465/20H lidhur me njohjen e diplomave të të diplomuarve të regjistruar në vitin akademik 2013/14.
- II. Ky vendim është i vlefshëm vetëm për të diplomuarit e universitetit të Gjilanit sipas listës së bashkëngjitur në vendim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi

Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për njohjen e diplomave të të diplomuarve të Universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka" të regjistruar në vitin akademik 2013/14.

Në mbledhjen 82 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, të mbajtur më 25.06.2020, u trajtua kërkesa e lartpërmendur pjesë e të cilës ishte edhe vendimi 03/118 i datës 06.03.2013 i Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit Publik të Gjilanit, vendimi i Kuvendit të Kosovës për ratifikimin e

vendimit të qeverisë për themelimin e Universitetit Publik të Gjilanit dhe marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Gjilanit.

Duke u bazuar në dokumentacionin e trajtuar, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka"
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.



*Gazmend Luboteni*  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë